

VENDIM
Nr. 361, datë 5.6.2024

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 206, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË STACIONIT TË ZJARRFIKËSES DHE TË
GODINËS SË BORDIT TË KULLIMIT, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E
BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 206, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2 Bashkisë Kavajë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi, në masën 12 021 437 (dymbëdhjetë milionë e njëzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 456 768 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 11 564 669 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku